



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 80 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 21/07/2022

VENDIM

Nr.20, date 21 /07/2022

PËR

PROBLEMATIKAT E KONSTATUARA NË DIGAT E UJEMBLEDHËSIT TË GJANCIT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 21.07.2022 mori në shqyrtim Problematikat e konstatuara gjatë vizites në terren të ekipit të KKDM në datën 15.07.2022. Gjatë kësaj vizite rezultoi se në kreshtën e digave, anën e poshtme dhe të sipërme të saj ka pemë dhe shkurre të larta me lartësi mbi 2 m të larta të cilat jo vetëm demtojnë trupin e digës por krijojnë kushte për rritjen e filtrimeve në trupin e digës.

Gjithashtu, Bordi i Kullimit dhe Ujitjes në Korce nuk ka një rregullore të shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të digës në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 të mësipërme si dhe Vendimit të KKDM Nr. 3, datë 09.10.2020 "Udhëzues i përgjithshëm për hartimin e rregullores së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të digave"

Pas diskutimeve të te gjithë antareve, KKDM

VENDOSI:

1- Ti kërkojë Bordit të Kullimit në Korce dhe MBZHR si:

- Të kryejë brenda muajit shtator prerjen dhe pastrimin e pemëve dhe shkurreve të larta në trupin e digës.
- Të përgatit dhe të dorëzojë brenda muajit shtator, pranë KKDM rregulloren e shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të digës sipas Nenit 29 të VKM së mësipërme dhe Vendimit të KKDM Nr. 3, datë 09.10.2020 "Udhëzues i përgjithshëm për hartimin e rregullores së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të digave"

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

